

RAPORT PER PUNIME TOPOGRAFIKE

PROJEKT ZBATIMI

Objekti : "Rikonstrukcion Rruga " Ernest Bushati"

Projektues

NOVATECHSTUDIO sh.p.k.

TIRANE , 2024



Aksi rrugor “Ernest Bushati” shtrihet në skajin verior të qytetit të Shkodrës, në pjesën e sipërme të zonës “Industriale”. I pozicionuar në rajonin 3 në Bashkinë Shkodër ai kufizohet me rrugën ‘Gjovalin Gjadri’ në perëndim dhe shtrihet mes rrugës "Lodërtune" në veri dhe rrugës ‘Luigj Benusi’ në jug. Rruga kufizohet në 2 anët e saj me shtëpi banimi 1-3 kate. Pozicionohet reth 2km ne vije ajrore ne verilindje te qendres se qytetit te Shkodres.



Ne foto : pozicionimi i rruges "Ernest Bushati" ne kontekst te akseve kryesore rrugore dhe qendres se qytetit

Si fillim , me marjen e detyres se projektimit , u grumbulluan materiale te ndryshme hartografike qe perfshijne zonen e interesit , si p.sh harta perkatese e shkalles 1:25000 , harta dixhitale-kadastrale e perditrsuar e qytetit te Shkodres , etj.

Punimet gjeodezike dhe topografike per objektin ”Rikon struksion Rruga " Ernest Bushati", u kryen mbi bazen e kerkesave teknike te pergjitheshme dhe specifike te parashikuara nga Autoriteti Kontraktor. Grupi i Topografeve organizoi punen dhe zhvilloi punimet ne baze te pervojës se perftuar ne punimet e meparshme te kesaj natyre.

Keshtu , per kryerjen e rilevimit topografik ne objekt , si nje nga pjeset me te rendesishme te projektit , pasi u inspektua fillimisht siperfaqja qe do te rilevohej me qellim hartimin e projektit , se bashku me perfaqesues vendore , u krye rikonicioni (përnjohja) e vendit ku do të kryhet investimi ku na u bene me dije edhe elemnte te objektit qe ishin jo lehtesisht te dallueshem ne veshtrimin e pergjithshem (si psh. Gjendje e rrjeteve ekzistuese infrasatrukturore etj).

Para fillimit të rilevimit u ndërtua rrjetin poligonal, pikat e të cilit u fiksuan ne vend në pjese të forta e të qëndrueshme si në pjese muri , shtylla ekzistuese , bordura betoni etj.

Rilevimi u krye mbi bazën e kërkesave dhe të standarteve të shkallës 1 : 500. Dendësia e pikave detaje është e tille që realizon çdo kërkesë të projektimit në planimetri dhe naltimetri.

Për të dhënë njohuri të plota për sheshin e projektimit dhe të ndërtimit dhe për të parashikuar e parandaluar çdo paqartësi apo të papritur gjatë ndërtimit të veprës , u krye nje rilevim I plotë e i detajuar të sheshit të ndërtimit dhe më gjerë.

U hodh i plotë konturi I zones se interesit ne teresi duke përfshirë si godinat, rrugicat dhe trojet, sheshet , hyrjet ne prona , muret rrethues të pronave, etj.





Per "Novatech Studio" Shpk

Ing. Emil Nova

Lic. T 0056/2

